



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 25

Tiranë – E hënë, 20 shtator 2021

PËRMBAJTJA

Faqe

Urdhër i ministrit të Arsimit,
Sportit dhe Rinisë nr. 316,
datë 13.9.2021

Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit.....

3

Kërkesë e Ministrisë së
Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale nr. 3855, datë 20.9.2021

Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Shërbime konsulence për kolaudimin e ndërtesave të Spitalit Pediatrik QSUT”.....

6



URDHËR

Nr. 316, datë 13.9.2021

**PËR NJOFTIMIN E FILLIMIT TË
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN
E SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”,
MËNYRËN E VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE DHE AFATIN E
DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 48, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 7, të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin, që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit, do të jetë data 27.9.2021.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedurat që do të ndiqen për konkurrimin, për pozicionin anëtar të Bordit të Administrimit, si përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Universitetin e Shkodrës

“Luigj Gurakuqi”, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin: www.arsimi.gov.al.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1

**NJOFTIM
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE
TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT,
PËRFAQËSUES TË MINISTRISË
PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN, NË
UNIVERSITETIN E SHKODRËS “LUIGJ
GURAKUQI”**

Në zbatim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe të urdhrit nr. 316, datë 13.9.2021, të MASR-së, “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall njoftimin për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, si më poshtë:

Nr.	Institucioni publik i arsimit të lartë	Numri i anëtarëve për Bord Administrimi
1	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	- 3 anëtarë përfaqësues të MASR-së - 1 anëtar i përkohshëm, deri në përzgjedhjen e përfaqësuesit të studentëve



1. Përshkrim i përgjithshëm

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listave të propozuara nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

2. Kompetencat dhe funksionet e Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:

- garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
- me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë;
- jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

- përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe të personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;

- emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;

- miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;

- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

3. Kërkesat e pranimit

a) Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos ketë ndaj tij masë disiplinore në fuqi të largimit nga detyra;
- të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
- të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;
- të ketë integritet etik dhe profesional;
- të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
- të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënime me vendim jo përfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që

zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;

- të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

- të njohë të paktën një gjuhë të huaj;
- të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore.

4. Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit

- Kërkesë për aplikim ku të jetë specifikuar IAL-ja ku kandidon;

- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV - *Curriculum Vitae*);

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën *Bachelor*). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet vërtetimi i njohjes dhe i njësimit të diplomës/certifikatës, të lëshuara nga strukturat përgjegjëse përkatëse;

- Fotokopje të librezës së punës;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj;
- Vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga detyra;

- Formular i vetëdeklarimit i gjendjes gjyqësore;

- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1;

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2;

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3;

- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të

Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

5. Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të jetë deri në datën 27.9.2021 në një nga këto mënyra:

- a) me postë zyrtare, në adresë të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

- b) dorëzimi dorazi në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Dokumentacioni administrohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila vë në dispozicion të komisionit *ad-hoc* të ngritur me urdhër ministri, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.

6. Mënyra dhe koha kur do të shpallet lista e kandidatëve që do të kualifikohen

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të shpallë kandidatët e kualifikuar në faqen e saj zyrtare: www.arsimi.gov.al.

- Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit kryhet nga një komision *ad-hoc* i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili shqyrton dokumentacionin e paraqitur, brenda 10 ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe harton listën e kandidatëve të kualifikuar, që plotësojnë kriteret ligjore.

7. Masa e shpërblimit

Bazuar në VKM-në nr. 656, datë 31.10.2018, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njërive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj.



SHTOJCA NR. 1/1

VETËDEKLARIM MBI MOSANGAZHIMIN NË FUNKSIONE DREJTUESE PARTIAKE

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/2

VETËDEKLARIM MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit, që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi, për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA NR. 1/3

VETËDEKLARIM PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë, autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

KËRKESË

Nr. 3855, datë 20.9.2021

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR
SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“SHËRBIME KONSULENCE PËR
KOLAUDIMIN E NDËRTESAVE TË
SPITALIT PEDIATRIK QSUT”**

Tiranë, 20 shtator 2021

Njësia e Koordinimit të Projektit Shqipëri

Nr. i kredisë: 8466 ALL

ID e projektit: P144688

*Titulli i kontratës: Shërbime konsulence për
kolaudimin e ndërtesave të Spitalit Pediatrik
Referenca nr: HSIP/CS/CQ/12-2020*

Qeveria e Shqipërisë ka marrë një hua me vlerë prej 32.1 milionë EUR (50 milionë USD), hua e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për të financuar Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor (HSIP). Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) po vepron si administruuese e shumës së dhënë. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), këtu e referuar si “Klienti”, ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin dhe koordinimi i Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit përmes Ekipit të tij të Menaxhimit të Projektit (PMT). Objektivi i Projektit është të kontribuojë në përmirësimin:



Përmirësimi i efikasitetit të kujdesit në spitalet e përzgjedhura në Shqipëri, përmirësimi i menaxhimit të informacionit në sistemin shëndetësor dhe rritja e aksesit financiar në shërbimet shëndetësore. Për të përmirësuar aksesin dhe efikasitetin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, Projekti do të mbështesë:

- Komponenti 1: Përmirësimi i menaxhimit dhe i infrastrukturës së sektorit spitalor publik;

- Komponenti 2: Përmirësimi i Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor për Shërbimet Spitalore.

Nënkompentin 1, Projekti HSIP ka financuar rehabilitimin e Spitalit Pediatrik (një shtrirje horizontale dhe rehabilitim i një ndërtese ekzistuese). Sipas kuadrit ligjor shqiptar, vlefshmëria është e detyrueshme dhe pajtueshmëria do të mbulojë vlefshmërinë e dy ndërtimeve.

Vlerësuesi i punimeve të ndërtimit të objektit duhet të kontrollojë dosjen e objektit për të gjitha fazat e zbatimit të punimeve, në përputhje me Projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punëve dhe vlerën e kontratës (sipas detyrave të përcaktuara në ToRs).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po kërkon që firmat vendore të kryejnë këtë detyrë, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Konsulenti duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Kualifikimet e kompanisë konsulente:

Kjo detyrë do të kryhet nga një firmë vendore, e themeluar dhe e operuar sipas legjislacionit, rregullave dhe rregulloreve shqiptare:

- Kompania konsulente duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë në fushën e vërtetimit të punimeve civile;

- Kompania duhet të sigurojë të paktën dy kontrata të ngjashme gjatë pesë vjetëve të fundit, së bashku me letrat referuese nga institucionet për përfundimin e suksesshëm të kontratës;

- Aftësia për të komunikuar dhe për të përgatitur dokumentet në të dyja gjuhët: shqip dhe anglisht;

- *Curriculum vitae* të firmës konsulente, duke renditur të gjitha përvojat dhe kontratat e ngjashme;

- Kompania konsulente duhet të jetë në gjendje të ofrojë në versionin origjinal ose të certifikuar ligjor, licenca profesionale të vlefshme për të dyja detyrat, vlefshmëri.

- Konsulenti duhet të ketë një licencë të vlefshme “Validation”, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse, duke përfshirë të gjitha kategoritë, që mbulojnë punët e kërkuara sipas kësaj detyre. Kjo licencë mund të sigurohet nga vetë kompania ose përmes kontratës së nënshkruar midis kompanisë konsulente dhe individëve/firmave të tjera.

- NP - 1 (punime gërmimi në tokë)

- NP - 2 (ndërtime civile dhe industriale)

- NP - 3 (rindërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave civile dhe industriale)

- NP - 11 (ndërtesat për n/stacionet, dhomat e transformatorëve, linjat e tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

- NS - 1 (punime për prishjen e ndërtesave)

- NS - 2 (hidrosanitare, kuzhina, lavamanë, mirëmbajtje)

- NS - 3 (sistemi transportues ngritës)

- NS - 9 (punime strukturore speciale)

- NS - 12 (impiante teknologjike, termike dhe të ajrit të kondicionuar)

- NS - 13 (zbatimi i linjave telefonike dhe i sistemeve të telekomunikacionit)

- NS - 14 (shtëpiake, elektrike, telefoni, radiotelefon, TV etj.)

- NS - 18 (punime topogjeodike)

- NS - 19 (sistemet e zhurmës - e izolimit, për projektet e infrastrukturës)

Stafi kryesor i konsulentit duhet të përbëhet nga personeli i mëposhtëm i cili duhet të plotësojë kriterin përkatës në vijim.

Nr.	Pozicioni	Nr. i personelit
1	Menaxher projekti	1
2	Inxhinier civil	1
3	Inxhinier elektrik	1
4	Inxhinier mekanik	1
5	Inxhinier hidroteknik	1



Kualifikimet e kërkuara për personelin në pozicion kryesor janë si më poshtë:

Menaxher projekti: Msc. Master shkencor në inxhinieri civile, me të paktën 6 vjet eksperiencë në fushën e punimeve civile.

Inxhinier ndërtimi: Msc. Master shkencor në inxhinieri civile, me të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e punimeve civile.

Inxhinier elektrik: Msc. Master shkencor në inxhinieri civile elektrike, me të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e punimeve civile.

Inxhinier mekanik: Msc. Master shkencor në inxhinieri civile mekanike me një eksperiencë të paktën 5 vjet në fushën e punimeve civile.

Inxhinier hidroteknik: Msc. Master shkencor në inxhinieri civile hidroteknike, me një eksperiencë të paktën 5 vjet në fushën e punimeve civile.

Shënim. Të gjithë ekspertët e mësipërm duhet të kenë licenca profesionale të vlefshme të

lëshuara nga autoritet shqiptare në fushën e ekspertizës, origjinale dhe të noterizuara.

Firma që do të zgjidhet (pasi të ketë plotësuar kërkesat e kualifikimit minimal/përvojës së mësipërme), e cila do të renditet e para në bazë të kriterëve të vlerësimit/përzgjedhjes së shkurtër më poshtë, do të ftohet për negociata kontratash, gjatë së cilës firma e suksesshme do të kërkohej të përmbushë çelësin e mësipërm të kualifikimit të stafit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes Njesisë së Koordinimit të Projekteve (PCU), tani fton kompanitë konsulente të përshtatshme (Konsulentët) për të treguar interesin e tyre në ofrimin e shërbimeve. Kompanitë konsulente duhet të japin informacion që demonstrojnë se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet (siç përshkruhet më sipër). Kriteret e vlerësimit/listës së ngushtë janë:

Nr.	Kriteret e vlerësimit	Pikë
1	Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e aktivitetit	30
2	Numri i kontratave të ngjashme të përfunduara gjatë pesë vjetëve të fundit	60
3	Disponueshmëria e stafit kryesor të kualifikuar brenda firmës	10
TOTAL		100 pikë

Vëmendja e konsulentëve të interesuar tërhiqet nga paragrafi 1.9, ***Udhëzimi i Bankës Botërore: Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore*** (janar 2011, rishikuar, korrik 2014), duke përcaktuar politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: **Kualifikimi i Konsulentit (CQ)**, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Bankës Botërore, “Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve, sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore” (janar 2011, rishikuar, korrik 2014).

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është: Kualifikimi i Konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimet e Bankës Botërore, “Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve, sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve IDA nga huamarrësit e Bankës Botërore” (janar 2011, rishikuar, korrik

2014). Caktimi duhet të kryhet brenda 30 dhjetorit 2022. Kontrata do të jetë një shumë e njëjtë.

Informacion i mëtejshëm mund të merret në adresën më poshtë gjatë orarit të punës 08:00 deri në 16:30 (e hënë deri të enjte) dhe 08:00 deri në 14:00 të premten, në adresën më poshtë). Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht ose me postë, ose me *e-mail*) deri më **4 tetor 2021**.

Ministria e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale

Adresa: Rruga e Kavajës nr. 53, Tiranë, Shqipëri

Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)

Projekti i Përmirësimit të Cilësisë së Shëndetësisë (HSIP)

Att: Blerina Dudushi

E-mail: hsip.dudushi@gmail.com

BlerinaDudushi@shendetesia.gov.al



Local Technical Assistance – Consulting Company

Tirana, 20th of September 2021

Albania Health System Improvement Project (HSIP)

Loan No: 8466 AL

Project ID Number: P144688

Assignment Title: Consulting Services for the validation of pediatric Hospital buildings
Reference No. HSIP/CS/CQ/12-2020

The Government of Albania has received a loan and a grant of totaling 32.1 million EUR (50 million USD), a loan of International Bank for Reconstruction and Development (IBRD) to finance the Health System Improvement Project (HSIP). The International Bank for Reconstruction and Development (“World Bank”) is acting as administrator of the amount provided. The Ministry of Health (MoHSP) herein after referred as “the Client” has overall responsibility for the Project, and the Project Coordination is responsible for the implementation of the Project through its Project Management Team (PMT). The objective of the Project is to contribute to improve

Improving the efficiency of care in selected hospitals in Albania, improving the management of information in the health system, and increasing financial access to health services. To improve access and efficiency of health care services in Albania, the Project will support:

- Component 1: Improving Public Hospital Sector management and Infrastructure.
- Component 2: Improving Health Information Management for Hospital Services.

Under Component 1, the HSIP project has financed the rehabilitation of pediatric hospital (one horizontal extension and rehabilitation of one existing building). As per Albanian legal framework, the validation is compulsory and the consultancy will cover the validation of two buildings.

The validator of the construction works of the facility must check the file of the facility for all stages of implementation of the works in accordance with the project (design), technical conditions of implementation, technical

specifications, as well as the destination of the facility, given the time limit set for performance of works and contract value (according to the duties set out in the ToRs.

The Ministry of Health and Social protection is seeking for local firms to conduct this assignment which fulfill the following criteria:

The consultant must meet the following requirements:

Qualifications of the Consulting Company:

This assignment will be carried about by a Local firm, established and operating according to the Albania legislation, rules and regulations.

- The Consulting Company should have at least 5 years of experience in the area of validation of civil works;
- The company must provide at least two similar contract during the last five year along with reference letters from institutions for successful contract completion;
- Ability to communicate and prepare the documents in both languages Albanian and English.
- The curriculum vitae of the consulting firm, listing all the experiences and similar contract.
- The consulting Company should be able to provide in original or legal certified version, valid professional licenses for both assignment, validation.
- The Consultant should have a valid “Validation” license, issued by responsible authorities, including all categories which cover the works required under this assignment. This license may be provided from the company itself or through signed contract between the consulting company and other individual/firms.

- NP - 1 (Excavation works on land)
- NP - 2 (Civil and industrial constructions)
- NP - 3 (Reconstruction and Maintenance of Civil and Industrial Buildings)
- NP - 11 (Buildings for N/Stations, transformer rooms, medium voltage lines and power distribution)
- NS - 1 (Works for demolition of buildings)
- NS - 2 (Hydro-sanitary Plants, Kitchens, Washers, Maintenance)
- NS - 3 (Lifting Conveyor System)



- NS - 9 (Special Structural Works)
- NS - 12 (Technological, thermal and air conditioning plants)
- NS - 13 (Implementation of telephone lines and telecommunication systems)
- NS - 14 (Domestic, electrical, telephone, radiotelephone, TV, etc.)
- NS - 18 (Topogeodic Works)
- NS - 19 (Noise-Isolation Systems for Infrastructure Projects)

Key consultant's staff should be composed by the following staffs which should meet the following respective criterion.

No.	Position	No. of personnel
1	Project Manager	1
2	Civil engineer	1
3	Electrical engineer	1
4	Mechanical engineer	1
5	Hydrotechnical Engineer	1

The required qualifications for the personnel in key position are given below:

Project Manager: Msc. Master of Science in civil engineer with at least 6 years expertise in the area of validation of civil works;

Civil Engineer: Msc. Master of Science in civil engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

Electrical Engineer: Msc. Master of Science in civil electrical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

Mechanical Engineer: Msc. Master of Science in civil mechanical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

Hydro technical Engineer: Msc. Master of Science in civil hydro technical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works.

The consultant may provide also non key experts.

Note: *All the above experts should have valid professional Licenses issued by Albanian Authorities in the field of their expertise, in original or notarized version*

The firm who will be selected (after fulfilling the minimum qualification/experience requirements above) as highest ranked based on the evaluation/shortlisting criteria below, will be invited for contract negotiations, during which, the successful firms will be required to fulfill the above key staff qualification.

The Ministry of Health and Social Protection, through Project Coordination Unit (PCU) now invites eligible consulting companies ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Consulting Companies should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services (as described above). The evaluation/shortlisting criteria are:

No.	Evaluation Criterion	Points
1.	Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment	30
2.	Number of assignment-related contracts completed during last five years.	60
3.	Availability of qualified key staff within the firm	10
TOTAL		100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's [Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers](#) (January 2011, revised July 2014), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest. . The selection method to be applied is **Consultant Qualification (CQ)**, in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by

World Bank Borrowers" (January 2011, revised July 2014).

The consultant should be a Local Firm. The selection method to be applied is Consultants Qualification (CQ) in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers" (January 2011, revised July 2014). The assignment should be performed



within 30th of December 2022. The contract will be Lump Sum.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday In the address below). Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **4th of October 2021**.

Ministry of Health and Social Protection
Adress: Rruga e Kavajës No. 53, Tirana -
Albania
Project Coordination Unit (PCU)
Health System Improvement Project
(HSIP)
Att: Blerina Dudushi
***E-mail:* hsip.dudushi@gmail.com**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021